



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

---

**VENDIM**

*Nr. 157 Datë 15.11.2012*

**MBI**

***KËRKESËN E SHOQËRISË KESH SH.A PËR ALOKIMIN E  
KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT PËR MUAJIN DHJETOR  
2012***

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, gërma “ç”, paragrafi “ii”, dhe 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës 7, gërma “b”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe Kapitullit X, pika 2, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 15.11.2012, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a nr. 5024 Prot. datë 12.11.2012, si dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut,

**Konstaton se:**

- Nivelet e rezervës hidrike ne kaskadën e lumit Drin si dhe basenet e tjera te HEC-eve qe operojnë ne vendin tone nuk jane ne nivelet optimale per te siguruar nje furnizim te vazhdueshem per muajt ne vijim. Nga raportimet periodike te bera prane ERE, rezulton se niveli i hidrocentralit te Fierzes eshte 269 metra.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 633, datë 3.10.2012, lejon KESH sh.a që të bëjë importet e energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë dhe mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes.

- Prodhimi vendas i energjise elektrike nuk ploteson kerkesat per energji eletrike te konsumatoreve tarifore.
- Ne rekomandimin e datës 19.07.2012, Sekretariati i Vjenës me qëllim që të sigurohet furnizimi pa ndërprerje i konsumatorëve tariforë ka konsideruar te mundshme alokimin e kapaciteteve subjektit mbartës te detyrimit për sigurimin e energjisë elektrike për konsumatorët tarifore, jashtë ankandeve vjetore/mujore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

### **Vendosi:**

1. OST sh.a ti alokojë me të drejta të siguruara pa pagesë shoqërisë KESH sh.a kapacitetet e lira ndërkufitare të interkonjeksionit për muajin Dhjetor 2012, ne drejtim importi, për kryerjen e importit të energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë.
2. OST sh.a ti alokojë me të drejta të siguruara, ne baze te pageses se vleres te ankandit vjetor, Furnizuesve të Kualifikuar kapacitetet e lira ndërkufitare të interkonjeksionit për muajin Dhjetor 2012, ne drejtim importi, ne sasine qe i korrespondon proporcionalisht kontratave që kanë për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve të kualifikuar dhe qe nuk mbulohen nga kapacitetet e alokuara ne ankandin vjetor furnizuesve te kualifikuar.
3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a, OST sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a, për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**